



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:256981

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05445995

P.nr.3274/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale të akuzuarit E. O. nga F. M. KK O. i akuzuar për veprën penale Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.3251/21 të datës 16.11.2021, pas mbajtjes të shqyrtimit gjyqësor publik me datë 12.02.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Nazmi Krasniqi, të dëmtuarit Z. M. dhe i akuzuari E. O. me mbrojtësin sipas autorizimit Av. Burim Sallova, me datë 15.02.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 13.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari E. O., i biri i S. dhe H., e gjinisë I., i lindur me datë, në fshatin M... Komuna O... me adrese banimi ne Qendrën e vjetër shkollore ne O..., pensionist, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, i nacionalitetit Boshnjak, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363 par. 1 nën par. 1.3 të KPPRK-së

LIROHET NGA AKUZA

Sepse:

Prej datës 14.04.2021, i pandehuri, me dashje ka uzurpuar pronën e paluajtshme banesën në sipërfaqe prej 60.32 m, e cila banese gjendet në qendrën shkollore në O... pronë e tani te dëmtuarit Z.. M., në atë mënyrë që i pandehuri edhe përkundër kërkesës se pronarit-të dëmtuarit që ti liroje banesën në fjalë, i njëjti ka vazhduar ta mbaje të uzurpuar pronën, ashtu që në këtë rast të dëmtuarit vazhdon ti shkaktoje dem të konsiderueshëm material.

- *Me këtë kishte për të kryer veprën penale Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 par.1 të KPRK-së.*

Pala e dëmtuar Z. M., me adresë në Fshatin K. R. e S. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo-juridik.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.3251/21 të datës 16.11.2021, ndaj të akuzuarit E. O. për shkak të dyshimit të bazuar mire se ka kryer veprën penale *Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 par.1 të KPRK-së* (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësorë me datë 19.12.2023 dhe 12.02.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Nazmi Krasniqi, të akuzuarit E. O. dhe mbrojtësit të tij Av Burim Sallova dhe të dëmtuarit Z.M..

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se gjatë shqyrtimit gjyqësor në çështjen penale kundër të pandehurit E. O. pas administrimit të gjitha provave material dhe personale u vërtetua gjendja faktike se i pandehuri E. nga dt.14.04.2021 e në vazhdimësi deri më sot me dashje ka uzurpuar pronën e paluajtshme banesën me sip.60.32m2 pronë e të dëmtuarit Z. M. në atë mënyrë që edhe përkundër kërkesës së të dëmtuarit që I pandehuri të ja liroj banesën I pandehuri ka vazhduar ta mbaj të uzurpuar pronën e të dëmtuarit duke pamundësuar të dëmtuarit që pronën e tij ta shfrytëzoj në mënyrë të ligjshme për çka konsiderojmë se me veprimet e të pandehurit janë plotësuar të gjitha elementet e veprës penale uzurpim i pronës së paluajtshme nga neni 320 par.1 I KPRK-së.

Edhe pse i pandehuri gjate gjithë procedurës penale nuk e ka pranuar fajësinë lidhur me përgjegjësin e tij dhe veprën me të cilën ngarkohet vërtetimi I plote I gjendjes faktike si në dispozitiv të aktakuzës u vërtetua nga i dëmtuari I dëgjuar në cilësi të dëshmitarit I cili në mënyrë të qarte e sqaroi para gjykatës se si i njëjti pas dy kërkesave të bëra tek I pandehuri nga data 14.04.2021 nuk ka mundu të shfrytëzoj banesën e tij andaj një deklaram I tille është I qarte dhe I besueshëm për faktin se ka mbështetur edhe në provat material të cilat u administruan gjate shqyrtimit gjyqësor dhe nuk len në asnjë mënyrë mëdyshje rreth kredibilitetit të dëshmisë se tij.

I pandehuri gjate mbrojtjes së tij si në polici e ashtu edhe gjate shqyrtimi gjyqësor përkundër faktit se e mohon veprën penale i njëjti e vërtetoi faktin se është duke jetuar në banesën e të dëmtuarit, po ashtu nga ana e të dëmtuarit ka pas disa here kërkesa për ta liruar dhe i njëjti nuk ka liruar banesën e të dëmtuarit, duke dhënë arsyetime të ndryshme edhe duke e ditur se i njëjti nuk është pronar legjitim i banesës në fjalë, andaj gjykatës I propozojmë që mbrojtjes së të pandehurit të mos ja fal besimin pasi që është në kundërshtim me provat që janë administruar gjate këtij shqyrtimit dhe i pandehuri një mbrojtje të tille e bene për qellim të ikjes së përgjegjësisë penale.. Andaj nga të lartcekurat konsiderojmë se nga veprimet e të pandehurit janë plotësuar të gjitha veprimet për veprën të cilën akuzohet për çka kërkojmë nga ana e gjykatës që I pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit dhe të urdhërohet që të liroj/kthej të dëmtuari Z. M. pronën përkatësisht banesën e tij.

I dëmtuari Z. M. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e mbështes në tersi me fjalën e prokurorit të shtetit dhe nuk kam diçka tjetër për të deklaruar.

Mbrojtësi i të akuzuarit E. O. Av. Burim Sallova në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se I propozojmë gjykatës që pas administrimit të provave të mbrojturim tim të shpall të pafajshëm pasi siç u tha gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka qene qëllimi që I njëjti të uzurpoj pronën mirëpo I njëjti duke pritur rregullimin e dokumentacionit për shkak të bisedës që kanë pasur për shitblerjen e banesës I mbrojturi im ka qëndruar deri më tani në banesë, nuk është diskutuese ajo se I mbrojturi im mund të liroj banesën në momentin që merr konfirmimin nga I dëmtuari që I njëjti nuk do ta shes banesën e tij, po ashtu I mbrojturi im që nga hyrja në banesë e deri në bisedën për

shitblerjen e banesës, janë paguar të gjitha qerat sipas marrëveshjes ë kanë pasur. Po ashtu I vije keq për rastin që ka ndodhur mirëpo këtë e thotë për shkak se ka qene duke pritur për rregullimin e dokumentacionit për rregullimin e shitblerjes së banesës, I njëjti deri më tani nuk ka mundur të dëshmoj tek noteri dhe të sjell një flete poseduese me te cilën vërtetohet se prona në të cilën jeton I mbrojturi im është pronë e Z. M., po ashtu I mbrojturi im që në momentin kur Z. M. kërkon që të I lirohet banesa është në gjendje që të beje atë dhe atë brenda javës.

I pandehuri E. O. në mbrojtjen e dhen dhe në fjalën përfundimtarë ka deklaruar se në banesën e të dëmtuarit ka hyr me pëlqimin e këtij të fundit e po ashtu për kohën sa i njëjti ka qëndruar aty ka paguar qiratë mujore më tej ka deklaruar se banesën nuk e ka liruar për shkak se i dëmtuari i kishte premtuar se nuk do të kthehej asnjëherë në O., në tersi e ka mbështetur fjalën e mbrojtësit dhe nuk ka për të shtuar apo plotësuar asgjë tjetër lidhur me këtë çështje.

Pas procedimit të provave material dhe personale vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhmë ri me njëra tjetrën si dhe pas paraqitjes së fjalës përfundimtare të palëve në këtë procedurë gjykata vërtetoi se në veprimet e të pandehurit nuk janë konsumuar elementet e veprës penale Uzurpim i paligjshëm i pronës nga neni 320 par 1 të KPRK-së.

Për Gjykatën por as për palët në procedurë nuk ishin fakte kontestues së prona në të cilën i pandehuri qëndron nuk ishte pronë e tija madje këtë fakt ai vet e kishte pohuar, nuk ishte fakt kontestues as për gjykatën e as për palët në procedurë se pronar legjitim i pronës banesës me sipërfaqe 60.32m² ishte i dëmtuari Z. M., e kontestues nuk ishte as fakti se i pandehuri kishte hyre në posedim respektivisht në banesën e të dëmtuarit në bazë të një marrëveshje gojore qe kishte arritur me të dëmtuarin për lëshimin e banesës me qira, por kontestuese ishte fakti nëse prona ishte uzurpuar nga i pandehuri respektivisht ne veprimet e të pandehurit nëse ishin konsumuar elementet e veprës penale Uzurpim i paligjshëm i pronës ashtu sikurse parashihet në nenin 320 par 1 të KPRK-së.

Gjykata nga provat e administruara si ato personale dhe materiale e veçanërisht nga ato personale referuar këtu dëshmisë së të dëmtuarit-dëshmitarit Z. M. kishte vërtetuar se i pandehuri dhe i dëmtuari kishin arritur një marrëveshje gojore për lëshimin e banesës me qira dhe në bazë të asaj marrëveshje i pandehuri kishte hyrë në pronën e të dëmtuarit Z. M. ku gjatë kohës se qëndrimit të tij kishte paguar qiratë mujore të përcaktuar nga i dëmtuari, por kur i dëmtuari kishte kërkuar lirim e pronës nga i pandehuri i njëjti nuk kishte liruar atë.

Referuar dispozitës së nenit 320 par 1 të KPRK-së ku parashihet vepra penale e uzurpimit të pronës në mënyrë decidive Kodi ka paraparë se Uzurpim i paligjshëm i pronës nënkupton se *“Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme uzurpon pronën e paluajtshme të personit tjetër apo një pjesë të saj, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.”* Në rastin konkret Gjykata duke marr parasysh edhe interpretimin juridik të kësaj dispozite vije në përfundim se përderisa i pandehuri në pronën e të dëmtuarit ka hyrë në bazë të një marrëveshje gojore për lëshimin me qira të banesës nuk kemi të bëjmë me uzurpim.

Si element thelbësor për kryerjen e kësaj vepre penale pra shihet se është pushtimi i kundërligjshëm i pronës, përkatësisht nga çdo veprim i pambështetur në ligj, me të cilin veprim pronari ligjor pengohet ose pamundësohet në shfrytëzimin e qetë të pasurisë së tij. Mirëpo nëse i referohemi rastit konkret nga i pandehuri nuk është pushtuar në mënyrë të kundërligjshme prona e të dëmtuarit.

Gjykata në rasti konkret vlerëson se është tërësisht e natyrës civile çështja kur pronari legjitim i banesës bazuar në dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore, mund të kërkojë mbrojtje nga çfarëdo shqetësimi në shfrytëzimin e pronës së tij, ka të drejtë që, në përputhje me këto dispozita, të kërkojë mbrojtje ligjore me padi për pengim posedimi apo padi për lirim të pronës por sa i përket natyrës penale të çështjes Gjykata vlerëson se nuk janë konsumuar elementet e veprës penale për të cilat pretendon Prokuroria.

Gjykata vlerëson se kjo veprë penale mund të kryhet me çdo veprim që ka për qëllim uzurpimin e paligjshëm të pronës së huaj – kur pushtimi i një prone të tillë, (*futja në posedim e pronës së paluajtshme*), nuk është bërë me pëlqimin e pronarit legjitim apo kur nuk është i mbështetur mbi ndonjë veprim ligjor juridik pra në këtë rast i pandehuri është vendosur në banesën e të dëmtuarit me pëlqimin e tij – pronarit legjitim Z. M. i cili këtë fakt e ka pohuar edhe para Gjykatës gjatë mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale.

Për kryerjen e kësaj veprë penale është e nevojshme dashja si element subjektiv i veprës penale që përfshin në vete vetëdijen e të pandehurit se po e pushton pronën e huaj, pa leje të pronarit legjitim, dhe kjo nënkupton se elementet e kësaj veprë penale janë konsumuar vetëm kur pushtimi i pronës është bërë pa pëlqimin e pronarit ose të afërmeve të tij, e në këtë rast dispozitat e ligjit kanë paraparë se nuk është e domosdoshme që pëlqimi të jetë vetëm formal, i shkruar, por mund të jetë edhe gojor.

Gjykata me provat me të cilat ka disponuar në këtë çështje penale nuk ka arritur të vërtetojë përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, nuk ka provë e cila mbështet faktin se i pandehuri ka uzurpuar pronën e të dëmtuarit.

Gjykata pati parasysh edhe pretendimet e prokurorit të shtetit mirëpo të njëjtat ishin të pa bazuara kjo për faktin në veprimet e të pandehurit nuk janë konsumuar elementet e kësaj veprë penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës gjykata e mori bazuar në nenin 453 par 1 të KPPRK.

Nga sa u tha më lart, në kuptim të nenit 363, par. 1, nën par. 1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.3274/21 më datë 13.03.2024

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrijnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.